



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

## BALKAN YOUTH THINKATHON 2023 UNIVERSITETI AMERIKAN NË BULLGARI

Universiteti Amerikan në Bullgari organizon për herë të parë konkursin Balkan Youth Thinkathon, në të cilin do të marrin pjesë 28 studentë nga Ballkani, të cilët do të konkurojnë në ekipe për të krijuar një fushatë ndërgjegjësimi publik rreth NATO-s.

Aplikantët e suksesshëm do të ftohen të marrin pjesë fizikisht në kampusin e Universitetit Amerikan në Bullgari.

Pjesëmarrësit do të udhëzohen nga praktikues dhe akademikë të diplomacisë publike, të cilët do t'i udhëheqin në hartimin e një fushate ndërgjegjësimi publik të orientuar drejt të rinjve. Fituesi do të ketë mundësinë të ndajë rekomandimet e tij me përfaqësuesit e NATO-s në Bruksel.

Thinkathon ofron:

- mundësinë për t'u takuar me studentë nga Ballkani Perëndimor dhe Bullgaria;
- mundësinë për t'u takuar dhe trajnuar nga profesionistë, praktikues dhe akademikë në fushën e diplomacisë publike;
- mundësinë për të fituar një udhëtim të paguar me të gjitha shpenzimet në Bruksel për të prezantuar idetë para zyrtarëve të NATO-s;
- akomodim dhe ushqim falas për kohëzgjatjen e Thinkathon-it;
- rimbursimi i kostove të udhëtimit- maksimumi 150 euro për person.

Procesi i aplikimit është i hapur për aplikantët e moshës 18-24 vjeç. Ju lutemi dërgoni CV dhe një video 3-minutëshe mbi “NATO, vendi im dhe unë” në [thinkathon@aubg.edu](mailto:thinkathon@aubg.edu). Aplikantët e suksesshëm do të përzgjidhen nga një komision i pavarur.

Lutemi gjeni më poshtë linkun për aplikim: <https://www.aubg.edu/balkan-youth-thinkathon/>